



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 112/2 Prot.

Tiranë, më 05.02.2024

**V E N D I M**

**Nr.34, Datë 05.02.2024**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mori në shqyrtim ankesën nr. 07 Regj, datë 23.01.2024, të paraqitur nga ankuesit z. G.S dhe z. E. M kundër Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, Sektori i Policisë Rrugore Elbasan, Punonjësi i Policisë E. K , në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “vendbanimit” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas pretendimeve dhe shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, ankuesit deklarojnë se:

Më datë 08.01.2024, ora 20:25, po udhëtonin me makinë në rrugën “Kozma Naska”, Elbasan dhe kanë marrë drejtimin nga rruga “Zogu i Parë”, Elbasan në drejtim të qytetit të Elbasanit, në mënyrë që të drejtoheshin nga autostrada për në drejtim të qytetit Tiranë. Gjatë udhëtimit, në orën 20:27, oficeri i policisë rrugore i ka sinjalizuar dhe u ka bërë shenjë ndalimi për të ndaluar mjetin. Menjëherë kanë hapur krahun dhe kanë ndaluar mjetin. Kanë hapur xhamin e mjetit për të përshëndetur oficerin e policisë dhe për të pyetur për shkakun e ndalimit. Punonjësi i policisë së Komisarariatit të Policisë Rrugore Elbasan, i cili iu ka bërë shenjë ndalimi, konkretisht punonjësi i policisë me nr.identifikimi 9019100, i identifikuar me emrin E. K , komunikoi me radio, duke pyetur : “Çfarë problemi ka automjeti Pezho?”. Përgjigja nga personi në radio ishte: “Janë pa rrip sigurimi dhe po përdorin telefona.”. Oficeri E. K i ka kërkuar ankuesit G.S , i cili ishte shofer, patentën dhe dokumentacionin e makinës. Ankuesi i ka dorëzuar dokumentacionin e makinës dhe patentën. Më pas, oficeri i policisë E. K , i ka pyetur: “Nga “Kavaja” jeni ju të dy?”. Ankuesit i janë përgjigjur që janë nga “Tirana” dhe më pas e pyetën pse po i pyeste, por nuk morën përgjigje në lidhje.

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Menjëherë oficeri i policisë, iu sqaron se të dy ankuesit ishin pa rrip sigurimi dhe se shoferi po përdorte telefonin gjatë drejtimit të mjetit. Ankuesi G.S , i drejtohet dhe i thotë oficerit të policisë, të shikonte nëse ishte me rrip apo pa rrip dhe nëse kishte telefon në dorë. Gjithashtu edhe ankuesi E. M , i cili ishte pasagjer dhe njëkohësisht pronari i makinës, i kërkon llogari oficerit të policisë, duke e pyetur nëse shikonte që ata ishin me rrip apo pa rrip. Oficeri pretendonte se ankuesit ishin pa rrip sigurimi dhe me telefon në dorë, ndërsa ankuesit pretendonin të kundërtën. Oficeri i policisë iu sqaron se në momentin që kishin ndaluar ishin me rrip sigurimi dhe pa telefon, por që rripin e sigurimit e kishin vendur gjatë ndalimit.

Ankuesit deklarojnë se, për të vërtetuar se kanë qenë me rrip, kanë bërë një video të shkurtër gjatë kohës që ishin të ndaluar në orën 20:31, ku duket qartë që kanë vendur rripin e sigurimit.

Midis ankuesve dhe oficerit të policisë është diskutuar në lidhje me faktin nëse ishte oficeri i policisë që i kishte konstatuar pa rrip dhe me telefon në dorë apo ishte njoftuar nga të tjerë. Ankuesit deklarojnë se oficeri i policisë, i cili fillimisht pretendote se ishte ai që i kishte konstatuar në shkelje ndërroi versionin duke i bërë me dije se kishte qenë “komandanti” ai që kishte konstatuar se ankuesit kishin qenë pa rripa sigurimi dhe duke përdorur aparatën telefonik gjatë drejtimit të mjetit. Ankuesi E. M , i cili ishte pasagjer në mjet, i ka kërkuar oficerit të policisë se duhet të vinte komandanti për të plotësuar procesverbalin e konstatimit të shkeljes, meqenëse ishte ai që kishte konstatuar shkeljen e supozuar. Ankuesi E.M, i ka bërë me dije oficerit të policisë se ai nuk mund të plotësonte procesverbalin e konstatimit të shkeljes, pasi nuk ishte ai që kishte konstatuar shkeljen por vetëm i kishte ndaluar dhe për rrjedhojë ai ishte në shkelje të ligjit.

Oficeri i policisë me nr.identifikimi 9019100, identifikuar me emrin E. K , ka plotësuar procesverbalin e konstatimit të shkeljes me nr.serie 2401080980, datë 08.01.2024, ora 20:00, ku është evidentuar shkelja administrative me përshkrimin : “170/8 “Përdorimi i rripave të sigurimit dhe sistemeve të fiksimit”; 171/2 “Përdorimi i syzeve optike dhe aparateve të tjera gjatë drejtimit të mjetit”; 171/3 “Përdorimi i syzeve optike dhe aparateve të tjera gjatë drejtimit të mjetit”. Në këtë akt, rubrika “Sanksion” është plotësuar në këtë mënyrë: “Të gjobitet me 15000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.” Në rubrikën “Komente” është plotësuar: “Drejtuesi i mjetit qarkullon me mjet duke përdorur aparatën telefonik si dhe pa vendos rripin e sigurimit. Zbriten 3 pikë. VKM 153 dt.07.07.2000 neni 350.”

Ankuesit deklarojnë se i kanë kërkuar oficerit të policisë që tek “*Deklarata e shkelësit*” të shënonin: “*Nuk jemi dakort pasi nuk je ti personi që supozohet që ka konstatuar shkeljen pasi ne të hapëm xhamin e makinës dhe po të prisnim ty njëherë, pasi erdhe, komunikove me radio ku pyete: Çfarë problemi ka automjeti Pezho. Përgjigja nga personi në radio ishte: Janë pa rrip sigurimi dhe po përdorin telefon. Pastaj ti ndërrove version ku na the që ju ka konstatuar komandanti*”, por punonjësi i policisë nuk ka bërë asnjë shënim sikurse ankuesit kishin kërkuar. Gjithashtu, në rubrikën “Kundravajtësi” nuk është nënshkruar procesverbali, pasi oficeri i policisë

nuk iu ka dhënë mundësinë që të nëshkruanin, por thjesht ua ka hedhur nga xhami brenda në makinë dhe është larguar.

Ankuesi E.M, deklaroi se i ka kërkuar oficerit të policisë që ti vendoste edhe atij gjobë meqënëse ishte konstatuar që edhe ai si pasagjer, kishte qenë pa rrip, për të patur mundësinë që ta kundërshtonte në gjykatë, por oficeri i policisë i ka deklaruar se vetëm shoferit i vendoset gjoba.

Në rubrikën përkatëse “Data/Vendi” është plotësuar si vijon: “ Data:08-01-2024, Ora 20:30; Adresa: Rr.Zogu Parë (Krasniqi), Qyteti Elbasan. Ankuesit deklaroi se, adresa që ka vendosur oficeri i policisë rrugore nuk është e saktë, pasi ata janë ndaluar në një vend tjetër më poshtë adresës së shënuar, pra larg vendit që është vendosur në procesverbal, rreth 200 metra larg.

Ankuesit shpjegojnë se, lidhur me shkeljet e pretenduara, punonjësi i policisë, ka referuar tek neni 170, pika 8 dhe 172, pika 2, të Kodit Rrugor. Duke qenë se, veprimet e kryera në kundërshtim me nenin 170/8, 171/2 të Kodit Rrugor, përbëjnë kundërvajtje administrative, atëherë gjejnë aplikim dhe dispozitat e ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjen administrative”. Në nenin 13 të këtij ligji parashikohet: “1. Për kundërvajtjen administrative parashikohet: a) marrja e gjobës në vend, në rastet kur ajo parashikohet nga ligji i veçantë; b) mbajtja e aktit administrativ që konstaton shkeljen apo e një dokumenti tjetër të barazvlefshëm me të nga personat e ngarkuar me ligj ose me akte të organeve të pushtetit vendor, në rastet kur konstatimi i shkeljes është i lidhur me vendin ku ndodh ngjarja.....”

Pra, sipas këtij neni, për kundërvajtjet administrative parashikohet mbajtja e aktit administrativ që konstaton shkeljen apo e një dokumenti tjetër të barazvlefshëm me të nga personat e ngarkuar me ligj ose me akte të organeve të pushtetit vendor, në rastet kur konstatimi i shkeljes është i lidhur me vendin ku ndodh ngjarja. Kjo mënyrë mbajtje dhe dokumentimi e aktit administrativ që konstaton shkeljen apo e një dokumenti tjetër të barazvlefshëm me të, gjen rregullim më të detajuar në nenin 14, të ligjit sipërcituar ku parashikohet se: “Mënyra e mbajtjes së procesverbalit apo e një dokumenti tjetër të barazvlefshëm me të: “1. Procesverbali i përmendur në shkronjën “b” të pikës 1, të nenit 13 të këtij ligji mbahet në vendin e kryerjes së kundërvajtjes dhe në kohën e konstatimit të saj, si rregull, në prani të kundërvajtjesit dhe të dëshmitarëve të pranishëm dhe nënshkruhet nga përpiluesi, kundërvajtësi dhe dëshmitarët e pranishëm, në rast se ka. Në procesverbal shënohet identiteti i kundërvajtjesit dhe lloji i kundërvajtjes. 2. Në rastet kur kundërvajtësi kundërshton nënshkrimin e procesverbalit, ky fakt evidentohet në atë procesverbal. 3. Në rast se ligji i posaçëm ka parashikuar ankim administrativ ndaj aktit të organit që ka shqyrtuar kundërvajtjen administrative, atëherë kopja e procesverbalit i dërgohet menjëherë organit kompetent për shqyrtimin e ankimit...”

Në interpretim të kësaj dispozite rezulton se, procesverbali i konstatimit të kundërvajtjes duhet të mbahet nga personi që konstaton kundërvajtjen, në vendin e konstatimit të kundërvajtjes dhe në kohën e kryerjes së saj, si rregull në prani të shkelësit, por edhe në mungesë të tij. Në rastin konkret procesverbali i konstatimit të shkeljes nr.serie 2401080980, datë 08.01.2024, rezulton se

është mbajtur nga punonjësi i policisë rrugore me nr.identifikimi 9019100, i cili në fakt nuk është punonjësi që e ka konstatuar shkeljen e supozuar, pasi kjo e fundit supozohet që është konstatuar nga një tjetër punonjës policie, më konkretisht nga komandanti, që ndodhej në vend tjetër.

Ankuesit pretendojnë se, procesverbali i konstatimit të shkeljes me nr.serie 2401080980, është mbajtur në kundërshtim me procedurën e parashikuar nga neni 14/1 i ligjit nr.10279/2010 “Për kundërvajtjet administrative”, pasi nuk është mbajtur nga punonjësi i policisë që ka konstatuar shkeljen, por është mbajtur nga punonjësi tjetër i policisë. Gjithashtu, në kundërshtim me ligjin, procesverbali i konstatimit të shkeljes, nuk është mbajtur në vendin ku ka ndodhur shkelja dhe në kohën kur është konstatuar ajo, për faktin se punonjësi i policisë rrugore që ka konstatuar shkeljen nuk dihet se ku (vendi) dhe kur (koha) e ka konstatuar shkeljen. Në këto kushte, nuk mund të konsiderohet e provuar shkelja, kur procesverbali i konstatimit të shkeljes nuk është mbajtur nga punonjësi i policisë rrugore që ka konstatuar shkeljen, por nga një punonjës tjetër. Këto shkelje të procedurës, në zbatim të shkronjës “b” të nenit 109, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, e bëjnë aktin e konstatimit të shkeljes nr.serie 2401080980, datë 08.01.2024, të paligjshëm dhe jo në përputhje me ligjin dhe rrjedhimisht duhet shfuqizuar.

Në nenin 35, të ligjit nr.49/2012, përcaktohet se: *“Organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë”*. Në rastin konkret, akti administrativ është nxjerrë jo me kërkesë të ankuesve. Në këto kushte, është detyrim i organit publik të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ. Rreferuar rrethanave në rastin konkret, organi publik duhet të provojë faktin se ankuesit, në cilësinë e drejtuesit të mjetit dhe pasagjerit, kanë qenë duke përdorur aparatit celular dhe kanë qenë pa rripa sigurimi. Meqënëse organi publik në këtë rast disponon kamerat e trupit të punonjësve të policisë, është detyrë e këtij organi ti vendosë në dispozicion të Komisionerit, për të vërtetuar shkeljen përtej çdo detyrimi.

Përfundimisht, ankuesit kërkojnë nga Komisioneri:

1. Konstatimin e diskriminimit nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, Sektori i Policisë Rrugore Elbasan, nga Punonjësi me nr.ID 9019100, i identifikuar me emrin E. K .
2. Shfuqizimin e procesverbalit të konstatimit të shkeljes ne.serial 2401080980 datë 08.01.2024, të punonjësit të policisë rrugore me nr.ID 9091900, në masën 15.000 lekë.
3. Detyrimin e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa të fshijë masën administrative nga sistemi i pasqyrimin të gjobave, si dhe kthimin e shumës së paguar me mandat arkëtimi nr.Ref: 60471976 në Postën Shqiptare.
4. Kthimin e 3 pikëve të hequra në sistemin e pikëve.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Në nenin 1 të LMD, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga LMD, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Nga shqyrtimi paraprak i parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga ankuesit pranë Komisionerit, konstatohet se:

Në bazë të Procesverbalit të Konstatimit të Shklejes Nr.2401080980, datë 08.01.2024, të përpiluar nga punonjësi i policisë E. K , në ngarkim të ankuesit G.S , i cili ka qenë duke drejtuar automjetin me targë xxxxxx, marka Peugeot, në pronësi të ankuesit E. M (i cili sipas ankuesve ka qenë pasagjer në automjet), rezulton se, në datën 08.01.2024 ora 20:30, në vendin rruga Zogu Parë (Krasniqi), qyteti Elbasan, është konstatuar se, drejtuesi i mjetit ka qenë duke qarkulluar me mjet, duke përdorur telefonin dhe pa vendosur rripin e sigurimit. Në Procesverbalin e Konstatimit të Shkeljes, është vendosur si referencë ligjore për shkeljen e konstatuar këto dispozita të Kodit Rrugor: - neni 170/8 “Përdorimi i rripave të sigurimit dhe sistemeve të fiksimit”; - neni 171/2 “Përdorimi i syzeve optike dhe aparateve të tjera gjatë drejtimit të mjetit”; dhe neni 171/ 3 “Përdorimi i syzeve optike dhe aparateve të tjera gjatë drejtimit të mjetit”. Rezulton se, ankuesi G.S , në cilësinë e drejtuesit të mjetit është gjobitur me 15000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë gjobë, si dhe në zbatim të VKM 153, datë 07.04.2000, neni 350, i janë zbritur 3 pikë nga leja e drejtimit, për shkak se ka qenë duke përdorur aparat telefonik si dhe pa vendosur rripin e sigurimit.

Referuar mandat arkëtimit me nr.Ref: 60471976, datë 09.01.2024, të lëshuar nga Posta Shqiptare sh.a, Zyra Postare Elbasan, Qendër, ankuesi ka paguar 50 % të vlerës së gjobës, 7500 (shtatë mijë e pesëqind) lekë.

Ankuesi G.S , e ka kundërshtuar Procesverbalin e Konstatimit të Shkeljes nr.2401080980, datë 08.01.2024, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan (DVP Elbasan). Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Organi Administrativ, pranë DVP Elbasan, me vendimin nr.68, datë 17.01.2024, ka vlerësua se, procesverbali është plotësuar në rregull dhe ka vendosur ta gjobisë ankuesin G.S me 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë, si dhe ti zbriten 3 pikë nga leja e drejtimit.

Ankuesit kanë paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi, duke pretenduar se janë diskriminuar për shkak të “vendbanimit” dhe për “çdo shkak tjetër”, nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, Sektori i Policisë Rrugore Elbasan, Punonjësi i Policisë E. K .

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrotjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ....b) ..... është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: “Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “ Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë” (shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrotje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa



një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Ligji Nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të ndrejtëpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të vendbanimit, të pretenduar nga ankuesi, duke sanksionuar në nenin 1, të tij se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : “*çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*”

Sipas ligjit, diskriminimi mund të shfaqet në disa forma, ndër të cilat, në formën e “*Diskriminimit i drejtpërdrejtë*”, e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji (neni 3/2) ose në formën e “*Diskriminimit të tërthortë*” e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë (neni 3/7). Ndërkohë, sipas nenit 6, të ligjit, trajtimi i ndryshëm është i përligjur dhe ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në

trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Si rregull, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se, shkakun e pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit, dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak. Megjithatë, vetëm identifikimi i një ose më shumë shkaqeve, të cilat mbrohen në mënyrë të shprehur nga ligji, nuk është e mjaftueshme për të ngritur një pretendim për diskriminim. Pala e cila pretendon se është diskriminuar për një ose më shumë se një, nga shkaqet e mbrojtura, duhet të parashtrojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun ose shkaqet e mbrojtur/a.

Komisioneri vlerëson se, “vendbanimi”, parashikohet shprehimisht si shkak i mbrojtur, në nenin 1, të LMD, por në bazë të fakteve, rrethanave dhe akteve të vendosura në dispozicion nga pala ankuese, nuk konstatohen elemente nga të cilat të mund të prezumohet se sjellja e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, bazohet apo ka si shkak, vendbanimin, të cilin pala ankuese e ka pretenduar si shkak diskriminues. Në thelb, kërkimi i palës ankuese konsiston në, paligjshmërinë e procesverbalit të konstatimit të shkeljes administrative me nr.seri 2401080980, datë 08.01.2024, të mbajtur nga punonjësi i policisë E. K , në ngarkim të ankuesit G.S .

Neni 1, i LMD, liston disa shkaqe, megjithatë kjo listë nuk është shteruese, por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes “për çdo shkak tjetër”. Thënë kjo, nuk presupozon se, termi “çdo shkak tjetër” përbën një shkak në vetvete. Rregullimi i bërë nga neni 1, i LMD-së nëpërmjet termit “çdo shkak tjetër” mundëson mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe të tjera, përveç shkaqeve të listuara shprehimisht në këtë dispozitë të ligjit, por duke identifikuar “shkakun” i cili pretendohet se gëzon mbrojtje në kuadër të termit “çdo shkak tjetër”. Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i palës ankuese se është diskriminuar “për çdo shkak tjetër” pa identifikuar asnjë shkak konkret, i cili më pas të vlerësohet nga ana e Komisionerit nëse përbën ose jo një shkak që gëzon mbrojtje, nuk përbën një pretendim për diskriminim, sipas parashikimeve të LMD-së.

Duke mbajtur në konsideratë standardet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, pala ankuese nuk ka ngritur pretendime për diferencë në trajtim ose për dështimin për të trajtuar ndryshe rastin e tij, për shkak të vendbanimit, të pretenduar si shkak diskriminues. Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri,



është një sjellje diskriminuuese. Një sjellje diskriminuuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuuese.

Në lidhje me ankuesin E. M , Komisioneri vlerëson se, ai nuk legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi, pasi ai nuk rezulton që të jetë cenuar në interesin e tij të ligjshëm, nga Procesverbali i Konstatimit të Shkeljes me nr.serie2401080980 datë 08.01.2024, pasi akti administrativ i kundërshtuar është nxjerrë vetëm në ngarkim të ankuesit G.S .

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, nuk hyn në kompetencën e këtij institucioni, shqyrtimi i pretendimeve që ankuesi G.S ka paraqitur kundër DVP Elbasan, Sektori i Policisë Rrugore Elbasan, Punonjësi i Policisë E. K , me ID 9019100, për sa kohë që ato nuk përbëjnë pretendime për diskriminim, sipas parashikimeve të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nr. 07 datë 23.01.2024, e paraqitur nga ankuesit G.S dhe E. M , kundër Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, Sektori i Policisë Rrugore Elbasan, Punonjësi i Policisë E. K me ID 9019100, nuk mund të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës Nr.07, datë 23.01.2024, të paraqitur nga ankuesit G.S dhe E. M , pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shkaku: Vendbanimi, çdo shkak tjetër  
Fusha: Të mira e shërbime  
Lloji i vendimit: Mospranim